



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

Nr. 766/11 Prot.

Tiranë, më 28.03.2026

VENDIM

Nr. 56, Datë 13.03.2026

“PËR NGRITJEN NË DETYRËN E PROKURORIT NË PROKURORINË E PËRGJITHSHME, TË PROKURORIT MARJETA ZAIMI”

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, i përbërë nga:

1. Mirela BOGDANI	Kryetar
2. Erind GERMENJI	Zv/kryetar
3. Sokol STOJANI	Anëtar
4. Zeqir HODA	Anëtar
5. Arta MANDRO	Anëtar
6. Ledina RIZA	Anëtar
7. Moisi DUDA	Anëtar
8. Vatë STAKA	Anëtar
9. Olger EMINAJ	Anëtar
10. Erind MERKURI	Anëtar
11. Erion FEJZULLA	Anëtar

Në mbledhjen e datës 13.03.2026, në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenet 159-161, 164 dhe vijues të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, nenet 18 e vijues, të Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të Këshillit të Lartë të Prokurorisë”, shqyrtoi çështjen me objekt:

“Për ngritjen në detyrën e prokurorit në Prokurorinë e Përgjithshme, të prokurorit Marjeta Zaimi”

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË:

Pasi mori në shqyrtim Relacionin shoqërues nr. 766 prot., datë 10.03.2026, të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, dëgjoji Relatorin znj. Ledina Riza, si dhe referuar bazës ligjore të lartpërmendur, përfshirë diskutimet në mbledhje mbi çështjen,

V Ë R E N:

1. Këshilli i Lartë i Prokurorisë¹, si një ndër organet qeverisë të sistemit të drejtësisë garanton statusin e magistratëve prokurorë, ku një aspekt të rëndësishëm zë karriera e tyre.
2. Në ushtrim të kompetencave të tij ligjore për zhvillimin e karrierës së prokurorëve, me Vendimin nr. 35, datë 03.03.2025, *“Për shpalljen e 3 (tre) vendeve vakante për procedurën e ngritjes në detyrë në Prokurorinë e Përgjithshme”*, Këshilli ka shpallur fillimin e procedurave për:
 - *Plotësimin e 3 (tre) pozicioneve vakante nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë në Prokurorinë e Përgjithshme, si vijon:*
 - Pozicion vakant nr. 1 në Prokurorinë e Përgjithshme;
 - Pozicion vakant nr. 2 në Prokurorinë e Përgjithshme;
 - Pozicioni vakant nr. 3 në Prokurorinë e Përgjithshme.
3. Në bazë dhe për zbatim të Ligjit nr. 96/2016, *“Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”*,² i ndryshuar, Këshilli³ ka miratuar Rregulloren *“Për ngritjen në detyrë në shkallët më të larta në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm”*⁴, e cila përcakton procedurat për ngritjen në detyrë në shkallët më të larta në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm dhe konkretisht, edhe në Prokurorinë e Përgjithshme.
4. Në datë 05.03.2025, Këshilli ka publikuar Njoftimin drejtuar kandidatëve për të shprehur interes dhe për të marrë pjesë në procedurat për ngritjen në detyrë në Prokurorinë e Përgjithshme përmes dorëzimit të dokumentacionit përkatës. Brenda afatit të caktuar në këto njoftime, disa magistratë prokurorë kanë kandiduar online në e-mailin zyrtar⁵ ose përmes shërbimit postar, për plotësimin e vendeve vakante sipas thirrjes së mësipërme duke paraqitur dokumentacionin e nevojshëm për përmbushjen e kriterëve ligjore.
5. Me Vendimin nr. 59, datë 27.03.2025, *“Për miratimin e listës së prokurorëve që kanë kandiduar nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë për vendet vakante në Prokurorinë e Përgjithshme, të shpallura me Vendimin nr. 35, datë 03.03.2025, të Këshillit”*, Këshilli ka miratuar listën e prokurorëve që kanë kandiduar për ngritje në detyrë për vendet vakante në këtë zyrë të prokurorisë. Kandidatët që kanë shprehur interes për ngritje në detyrë për të tre vende vakante janë prokurorët Antoneta Sevdari, Ervisa Hyka, Genci Mane, Marjeta Zaimi dhe Pranvera Pustina.

¹ Më tej, Këshilli

² Më tej, Ligji për Statusin

³ Miratuar me Vendimin nr. 222, datë 27.07.2022

⁴ Më tej, Rregullorja

⁵ Ievizjeparalele.shkurt_2025@klp.al

6. Pas miratimit të listave të kandidatëve, me Vendimin nr. 60, datë 27.03.2025, “Për caktimin me short të relatorit për procedurën e ngritjes në detyrë për kandidatët që kanë kandiduar për vendet vakante në Prokurorinë e Përgjithshme, të shpallura me Vendimin nr. 35, datë 03.03.2025, të Këshillit”, Këshilli ka hedhur shortin si dhe ka caktuar relatorët për ndjekjen e secilës prej procedurave të lëvizjes paralele. Për pozicionin vakant nr. 3 në Prokurorinë e Përgjithshme, si Relator ka rezultuar znj. Ledina Riza.

7. Kandidatët që kanë aplikuar në pozicionin vakante nr. 3, në Prokurorinë e Përgjithshme janë si vijon:

1. Antoneta Sevdari - prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Sh. I të Juridik. të Përgj. Tiranë (preferencë e dytë);
2. Ervisa Hyka - prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Sh. I të Juridik. të Përgj. Fier (preferencë e tretë).
3. Genci Mane - prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Sh. I të Juridik. të Përgj. Fier (preferencë e parë).
4. Marjeta Zaimi - prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Sh. I të Juridik. të Përgj. Tiranë (preferencë e dytë);
5. Pranvera Pustina - prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Sh. I të Juridik. të Përgj. Tiranë (preferencë e tretë);

8. Relatori përgjegjës ka njoftuar kandidatët për caktimin e relatorit, për të drejtën për të kërkuar përjashtimin e tij apo çdo anëtar i Këshillit nëse ekziston një nga shkaqet e parashikuara në Ligjin nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, ose për çdo shkak tjetër ligjor si dhe për fillimin e verifikimit të kushteve ligjore të kandidimit, nga ana e Këshillit. Asnjë nga kandidatët nuk ka kërkuar përjashtimin nga procedura të Relatorit apo ndonjë nga anëtarët e Këshillit.

9. Nga kandidatët e mësipërm rezulton se:

Kandidatja Ervisa Hyka, përmes Kërkesës dt. 26.05.2025, drejtuar Këshillit (regjistruar me nr. 1028/4, datë 26.05.2025) ka hequr dorë nga kandidimi⁶ në pozicionet vakante nr. 2 dhe nr. 3. në Prokurorinë e Përgjithshme.

Për kandidatin Genci Mane, në cilësinë e subjektit të rivlerësimit, në datë 29.07.2025, Kolegji i Posaçëm i Apelit ka vendosur ndryshimin e Vendimit nr. 598, datë 13.12.2022 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit Genci Mane. Për rrjedhojë, kandidati nuk gëzon më statusin e magistratit.

Kandidatja Antoneta Sevdari, përmes Kërkesës nr. 559, datë 18.02.2026, ka hequr dorë nga konkurrimi për pozicionin vakant nr. 3, në Prokurorinë e Përgjithshme. Njëkohësisht, kandidatja Antoneta Sevdari me Vendimin nr. 55, datë 13.03.2026, “Për

⁶ Bazuar në nenin 11, pika 8, të Rregullores

ngritjen në detyrën e prokurorit në Prokurorinë e Përgjithshme, të prokurorit Antoneta Sevdari”, të Këshillit është ngritur në detyrën e prokurorit në Prokurorinë e Përgjithshme, pas renditjes si e vetmja kandidate për pozicionin përkatës.

Kandidatja tjetër Pranvera Pustina, me Vendimin nr. 54, datë 13.03.2026, “Për ngritjen në detyrën e prokurorit në Prokurorinë e Përgjithshme, të prokurorit Pranvera Pustina”, të Këshillit është ngritur në detyrën e prokurorit në Prokurorinë e Përgjithshme, pas renditjes si e vetmja kandidate për pozicionin përkatës.

Kandidatja e vetme mbetur në garë për pozicionin nr. 3, në Prokurorinë e Përgjithshme, objekt i kësaj vendimmarrje, Marjeta Zaimi më parë ka hequr dorë përmes Kërkesës nr. 558, datë 18.02.2026, nga kandidimi për pozicionin nr. 2, në Prokurorinë e Përgjithshme.

10. Bazuar në nenin 48, pikat 7 dhe 8, të Ligjit për Statusin dhe nenet 9, germa “dh”, 19, pika 5, germa “a” dhe 21, pikat 1-3, të Rregullores, kandidatët e kualifikuar që plotësojnë kushtet ligjore të kandidimit për këtë pozicion vakant vijnë me procedurën e verifikimit të pasurisë dhe figurës, proces i cili realizohet nga Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale.
11. Me Vendimin nr. 29, datë 05.02.2026, “Mbi verifikimin e pasurisë dhe figurës të prokurorit Marjeta Zaimi, kandidate për pozicionin e Prokurorit në Prokurorinë e Përgjithshme”, Këshilli ka vendosur të vlerësojë të përfunduar verifikimin e pasurisë dhe figurës të prokurorit Marjeta Zaimi, kandidate për Prokuror në Prokurorinë e Përgjithshme dhe lejimin e saj të vijojë procedurën e mëtejshme për emërim në këtë pozicion.
12. Sipas neneve 22 e vijues të Rregullores, procedura e përzgjedhjes vazhdon me *fazën e dytë*, apo me renditjen e kandidatëve të kualifikuar menjëherë pas përfundimit me vendim të formës së prerë të verifikimit të pasurisë dhe figurës të të gjithë kandidatëve dhe, kur është rasti, edhe të vlerësimit etik dhe profesional të tyre. Në procedurën e përzgjedhjes përfshihen të gjithë kandidatët e kualifikuar.
13. Siç u tha më lart, kandidate e vetme për pozicionin për pozicionin nr. 3, në Prokurorinë e Përgjithshme është prokurorja Marjeta Zaimi, për të cilën Këshilli ka përfunduar verifikimin e pasurisë dhe figurës si dhe lejuar vijimin e procedurës së mëtejshme për ngritjen në detyrë.
14. Referuar neneve 23 dhe 24, të Rregullores, për renditjen e kandidatëve për pozicionin vakant nr. 1, në Prokurorinë e Përgjithshme bëhet një vlerësim krahasues i treguesve të kritereve dhe përparësive të përcaktuara dhe të renditura në nenin 48, pika 9, të Ligjit për Statusin, si dhe në Rregullore.

15. Në nenin 48, pika 9, të këtij ligji, parashikohet:

“9. Këshillat shqyrtojnë kandidimet dhe rendisin kandidatët që përmbushin kriteret, sipas rezultateve të mëposhtme:

- a) së pari, dy vlerësimet e mëparshme, duke pasur parasysh:
- i) që përvoja në pozicionet e komanduara, si magjistrat në skemën e delegimit, ose si anëtar i Këshillit që i ka mbaruar mandati tre vite përpara kandidimit do të ketë përparësi;
 - ii) në rastet e më shumë kandidatëve me rezultate të njëjta, magjistratët brenda grupit të kandidatëve me rezultatet më të larta të vlerësimit do të renditen sipas skemës së pikëve, të përcaktuar nga këshillat;
- b) së dyti, në rast se pas vlerësimit të bërë sipas shkronjës “a”, të pikës 9, të këtij neni, ka më shumë se një kandidat me pikë më të larta, Këshilli rendit këta kandidatë, sipas përvojës profesionale specifike që kërkohet për pozicionin e lirë;
- c) së treti, në rast se pas vlerësimit të bërë, sipas shkronjës “b”, të pikës 9, të këtij neni, ka më shumë se një kandidat me pikë më të larta, Këshilli rendit këta kandidatë sipas vjetërsisë si magjistrat ose jurist.”

16. Ndërsa, në nenin 24, pikat 1 dhe 2, të Rregullores, parashikohet se:

“1. Renditja e kandidatëve bazohet në vlerësimin krahasues të niveleve të dy vlerësimeve të mëparshme etike dhe profesionale. Kandidati me nivelet më të larta të vlerësimit etik dhe profesional renditet më lart.

2. Në rast se ka më shumë se një kandidat me rezultate të njëjta, për renditjen e kandidatëve me rezultatet më të larta zbatohen përparësitë sipas radhës së mëposhtme:

a) “niveli i vlerësimit të fundit” - Sipas kësaj përparësie, kandidati me nivelin më të lartë të vlerësimit të fundit etik dhe profesional renditet më lart;

b) “përvoja si prokuror i komanduar sipas nenit 53, të Ligjit për Statusin, si prokuror në skemën e delegimit sipas nenit 45, të Ligjit për Statusin, ose si anëtar i Këshillit, që i ka mbaruar mandati tre vite përpara kandidimit” - Sipas kësaj përparësie, kandidati që ka një nga këto përvoja renditet më lart;

c) “shumëllojshmëria e përvojave si prokuror i komanduar, si prokuror në skemën e delegimit ose si anëtar i Këshillit” - Sipas kësaj përparësie, kandidati që ka më shumë nga këto përvoja renditet më lart.

ç) “kohëzgjatja e përvojës si prokuror i komanduar, si prokuror në skemën e delegimit, ose si anëtar i Këshillit” - Sipas kësaj përparësie, kandidati me përvojën me kohëzgjatjen më të madhe në vite renditet më lart;...”

17. Duke qënë se, për pozicionin vakant nr. 3, në Prokurorinë e Përgjithshme mbetet në garë vetëm kandidatja Marjeta Zaimi, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës realizoi renditjen bazuar në vlerësimin krahasues të niveleve të dy vlerësimeve të mëparshme etike dhe profesionale të saj.

- i. Sipas Vendimit “Për vlerësimin e prokurorit”, të Prokurorit të Përgjithshëm, kandidatja Marjeta Zaimi është vlerësuar “Shumë mirë”, për vitin 2016 (që konvertohet “Shkëlqyeshëm” sipas nenit 25, pika 5, të Rregullores);
- ii. Me Vendimin nr. 107, datë 02.07.2025, “Për miratimin pa ndryshime të raportit të vlerësimit etik dhe profesional për prokurorin Marjeta Zaimi”, të Këshillit, kandidatja Marjeta Zaimi është vlerësuar me nivelin e vlerësimit “Shkëlqyeshëm”.

18. Sa më sipër, rezulton se kandidatja Marjeta Zaimi ka dy vlerësimet e fundit etik dhe profesional në nivelin “Shkëlqyeshëm”.
19. Meqënëse për këtë pozicion vakant nuk ka kandidatë të tjerë për t’u renditur si më sipër, në respektim të nenit 18, pika 2, të Kodit të Procedurave Administrative, ku përcaktohet se: *“2. Procedura administrative zhvillohet sa më shpejt të jetë e mundur, por jo më vonë se afati kohor i parashikuar me ligj për të, me sa më pak kosto për organin publik dhe për palët, në mënyrë që të arrihet çfarë është e nevojshme për një rezultat të ligjshëm”*, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës vlerësoi të vijojë edhe me ngritjen në detyrë të kandidates Marjeta Zaimi, në pozicionin e Prokurorit në Prokurorinë e Përgjithshme.
20. Përsa më sipër, bazuar në nenin 149/a, pika 1, germa “a”, të Kushtetutës, në nenin 48, pika 9, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenet 24, pikat 1 dhe 2, 25, pika 5, dhe 36, të Vendimit nr. 222, datë 27.07.2022, “Për ngritjen në detyrë në shkallët më të larta në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm”, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, **Komisioni i Zhvillimit të Karrierës i propozoi Këshillit ngritjen në detyrën si prokuror në Prokurorinë e Përgjithshme, të prokurorit Marjeta Zaimi.**
21. Sa i takon hyrjes në fuqi të aktit dhe krijimit të pasojave, në kuadër të mirëfunksionimit të sistemit të prokurorisë dhe kalimin në detyrë në mënyrë graduale, vlerësohet zbatimi i nenit 104, pika 3, i Kodit të Procedurave Administrative, ku përcaktohet se:
- “1. Një akt administrativ fillon të sjellë pasoja juridike ndaj palës së cilës i drejtohet apo interesat e së cilës preken nga akti, me njoftimin e përmbajtjes së aktit palëve.*
- 2. Akti administrativ i miratuar në heshtje fillon të sjellë pasoja juridike, në ditën e përfundimit të afatit për njoftimin e tij, sipas nenit 97 të këtij Kodi.*
- 3. Një akt administrativ mund të fillojë të sjellë pasoja juridike në një datë tjetër, të caktuar shprehimisht nga vetë akti, por në asnjë rast përpara njoftimit të palës, sipas pikës 1 të këtij neni. Në këtë rast, data e fillimit të pasojave juridike caktohet shprehimisht në pjesën e dispozitivit të aktit administrativ të shkruar.*
- 4. Një akt administrativ sjell pasoja juridike:*
- a) për sa kohë nuk është anuluar apo shfuqizuar, kryesisht apo si rezultat i ushtrimit të mjeteve ligjore administrative ose gjyqësore;*
- b) për sa kohë nuk ka përfunduar afati i aktit ose nuk është përmbushur qëllimi i tij; ose*
- c) për çfarëdo arsyeje tjetër të parashikuar nga ligji.”*
22. Referuar sa më sipër, pasojat juridike të aktit administrativ dhe fillimi i ushtrimit të detyrës efektive në zyrën e prokurorisë pritëse, në kuadër të mirëfunksionimit të sistemit të prokurorisë, do të krijohet në një moment të dytë, konkretisht në datë 24.03.2026.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 149/a, pika 1, germa "a", të Kushtetutës, në nenin 48, të Ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, në nenet 164, pika 8, 166 dhe 189, pika 1, germa "a", të Ligjit nr. 115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, në Ligjin nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", dhe në nenet 24, pikat 1 dhe 2, 25, pika 5, dhe 36, të Vendimit nr. 222, datë 27.07.2022, "Për ngritjen në detyrë në shkallët më të larta në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm", me propozim të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Ngritjen në detyrën e prokurorit në Prokurorinë e Përgjithshme, të prokurorit Marjeta Zaimi, duke filluar nga data 24.03.2026.
2. Të njoftohet me këtë vendim Prokurori i Përgjithshëm, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe prokurori Marjeta Zaimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit.

U shpall në Tiranë, sot më 13.03.2026.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

KRYETAR

Mirela Bogdani

ANËTAR

Sokol Stojani

ANËTAR

Ledina Riza

ANËTAR

Olgjer Eminaj

ANËTAR

Zeqir Hoda

ANËTAR

Moisi Duda

ANËTAR

Erind Merkuri

ZV/KRYETAR

Erind Germenji

ANËTAR

Arta Mandro

ANËTAR

Vatë Staka

ANËTAR

Erion Fejzulla